



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTTRRI

Numri i lëndës: 2025:000573

Datë: 14.01.2025

Numri i dokumentit: 06707842

P.nr.01/25

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurës Xh.B., me vendbanim në Vushtri rr. "...", për shkak të veprës penale *Prezantimi i rremë si person zyrtar* nga neni 409 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.2088/24, e datës 30.12.2024, më datë 14.01.2025 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.2088/24, e datës 30.12.2024, andaj gjykata konform dispozitës të nenit 495 të KPPK-së, jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

E PANDEHURA: Xh.B., nga i ati A., e ëma .H., e vajzërisë V., data e lindjes... në Vushtri, ku edhe tani jeton në rrugën "...", e martuar, ka të kryer shkollën e mesme, me numër personal të identifikimit ..., shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datën 29.11.2024, rreth orës 11:30 minuta në Vushtri, saktësisht në Spitalin Emergjent, prezantohet rrejshëm si person zyrtar dhe atë tek roja e sigurimit të spitalit këtu dëshmitari V.H., në atë mënyrë që ditën kritike e pandehura sapo arrin në spitalin e lartcekur, nxjerr telefonin dhe fillon të incizoj hapësirën brenda spitalit, me ç'rast nga dëshmitari i lartcekur i kërkohet që të ndërprejë incizimin me arsyetim se incizimi brenda hapësirave të spitalit nuk lejohet, e që në ato momente e pandehura i prezantohet atij si inspektore e fshehtë e dërguar nga Ministria e Shëndetësisë, ku pas verifikimit nga ana e policisë rezulton se e njëjta nuk ushtron pozitën e inspektore pranë Ministrisë së Shëndetësisë,

- Me këtë ka kryer veprën penale *Prezantimi i rremë si person zyrtar* nga neni 409 par.1 të KPRK-së

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 40, 43, 69, 70, dhe nenit 409 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 449, 462 dhe 495 të KPPK-së, e

Numri i lëndës: 2025:000573
Datë: 14.01.2025
Numri i dokumentit: 06707842

G J Y K O N

DËNIM ME GJOBË në shumën prej pesëqind euro (500 €), i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se e akuzuara refuzon ose nuk mund të paguajë këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të akuzuarës për çdo njëzetë (20) euro të dënimit me gjobë, nga një (1) ditë burgim.

DETYROHET e pandehura që në emër të paushallit gjyqësorë të paguajë shumën prej tridhjetë (30) euro, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguaj shumën prej njëzetë (20) euro.

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm ka paraqitur aktakuzë PP.II.nr.2088/24, e datës 30.12.2024, kundër të pandehurës Xh.B., me vendbanim në Vushtrri rr. "...", për shkak të veprës penale *Prezantimi i rremë si person zyrtar* nga neni 409 par.1 të KPRK-së.

Gjykatës i është kërkuar që kundër të akuzuarës të jep Urdhër Ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallëzimi penal dhe provat e bashkangjitura lidhur me bazueshmërinë e aktakuzës së prokurorisë së shtetit në drejtim të vërtetimit të fakteve se e akuzuara vërtetë e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me dispozitat ligjore të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, për veprën penale me të cilën akuzohet e pandehura Xh.B., ligjvënësi ka paraparë dënim me gjobë ose me burgim deri në një (1) vjet, që nënkupton se në rastin konkret zbatohen dispozitat ligjore të procedurës së veçantë nga neni 495 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenit 493 dhe 494 të KPPK-së, Gjyqtari i vetëm gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 të KPPK-së dhe konform dispozitave nga neni 495 par.1 të KPPK-së ashtu që morri vendim që ta pranojë kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2024-BD-1060, i datës 29.11.2024, procesverbali i marrjes në pyetje ankuesit V.H., i datës 29.11.2024, procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin Xh.B., i datës 29.11.2024 dhe raporti i oficerit, i datës 29.11.2024 dhe duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se në veprimet e të akuzuarës ekzistojnë elemente të veprës penale *Prezantimi i rremë si person zyrtar* nga neni 409 par.1 të KPRK-së, për këtë edhe i shqiptoi urdhër ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë gjykata mori parasysh rrethanat si: shkallën e përgjegjësive penale, shkallën e lartë të dashjes dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale.

Numri i lëndës: 2025:000573
Datë: 14.01.2025
Numri i dokumentit: 06707842

Andaj gjykata vlerësoi se edhe me këtë dënim të shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit në vështirim me nenin 38 të Kodit Penal të RKS-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprës penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e saj, që në të ardhmen e pandehura të ketë kujdes të shtuar që të mos bie në kundërshtim me ligjin, pasi që gjykata mundet të ashpërsojë dënimin kundër saj, si dhe me këtë dënim shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer dhe ngritë moralin dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par.2 nën par.2.6 të KPP-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 36 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal P.nr.01/25,
datë 14.01.2025

GJYQTARI
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi në afat prej 8 ditëve nga dita e marrjes me shkrim. Kundërshtimi i drejtohet kësaj gjykate me shkrim apo me gojë në procesverbal të gjykatës.